



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:224509

Datë: 11.02.2021

Numri i dokumentit: 01500307

C.nr.61/16

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Nexhat Qallapeku, në çështjen juridike kontestimore të paditësve A.G, A.G dhe L.G, të gjithë nga F.K, të cilët i përfaqëson sipas autorizimit Avokatura MBN Sh.P.K, me përfaqësues Mexhid Syla, Blerim Syla dhe Nexhat Syla, avokat nga Prishtina, Rruga “UÇK”, Kompleksi Qafa, Kati i II-të, numër 25, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S..”, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Yll Musa, specialist ligjor i të paditurës, me objekt të kontestit kompensim i dëmit, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor publik të datës 01.02.2021, të mbajtur me prani të përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse, me datë 11.02.2021 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT kërkesëpadia e paditësve A.G, A.G dhe L.G, të gjithë nga F.K.

II. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “S.....” me seli në Prishtinë, që paditësve në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material në aksidentin e shkaktuar me datë 27.11.2015, t’ia paguaj shumat si vijon:

1. Paditësit A.G

Në emër të dëmit jo material:

- Për dhimbje trupore - fizike, shumën prej 1,200.00€
- Për friken e pësuar, shumën prej 1,000.00€

Në emër të dëmit material:

- Për ushqim të përforcuar, shumën prej 100.00€
- Për përkujdesje të personit të huaj, shumën prej 30.00€
- Për shpenzime materiale gjatë kohës së shërimit 28.00€

2. Paditësit A.G

Në emër të dëmit jo material:

- Për dhimbje trupore - fizike, shumën prej 1,200.00€
- Për friken e pësuar, shumën prej 1,000.00€

Në emër të dëmit material:

- Për ushqim të përforcuar, shumën prej..... 100.00€
- Për përkujdesje të personit të huaj, shumën prej 30.00€

3. Paditësit L.G

Në emër të dëmit jo material:

- Për dhimbje trupore - fizike, shumën prej 1,300.00€
- Për friken e pësuar, shumën prej 1,100.00€

Në emër të dëmit material:

- Për ushqim të përforcuar, shumën prej..... 100.00€
- Për përkujdesje të personit të huaj, shumën prej 30.00€
- Për shpenzime materiale gjatë kohës së shërimit 20.00€

III. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “S....” me seli në Prishtinë, që paditësve t’ua paguaj kamatën në lartësi prej 8% për pjesën e aprovuar të padisë, dhe atë për dëmin material nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë (08.01.2016), kurse për dëmin jomaterial nga data e marrjes së këtij aktgjykimi (11.02.2021) e deri në pagesën e tërësishme, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 1,139.00€, e të gjitha në afat prej 15 ditësh pranimit të këtij aktgjykimi, në kërcënimin e përbarimit të detyrueshëm.

IV. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve, mbi shumat e aprovuara si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe atë për: paditësin A.G: për dhimbje trupore - fizike, shuma prej 1,800.00€, për friken e pësuar, shuma prej 1,000.00€, për ushqim të përforcuar, shuma 100.00€, për përkujdesje të personit të huaj, shuma 170.00€, për shpenzime materiale gjatë kohës së shërimit shuma prej 20.00€ dhe për rehabilitim klimaterik 300.00€; Për paditësin A.G: për dhimbje trupore - fizike, shuma prej 1,800.00€, për friken e pësuar, shuma 1,000.00€, për ushqim të përforcuar, shuma 100.00€, për përkujdesje të personit të huaj, shuma 170.00€ dhe për rehabilitim klimaterik 300.00€; Për paditësin L.G: për dhimbje trupore - fizike, shuma 1,700.00€, për friken e pësuar, shuma prej 900.00€, për ushqim të përforcuar, shuma prej 100.00€, për përkujdesje të personit të huaj, shuma prej 170.00€ dhe për rehabilitim klimaterik shuma prej 300.00€

A r s y e t i m

Paditësit A.G, A.G dhe L.G, të gjithë nga F.K, përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar, me datë 08.01.2016, në këtë Gjykatë kanë ushtruar padi, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S...”, me seli në Prishtinë, për kompensimin e dëmit.

Përfaqësuesi i paditësve në padi, përgjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka theksuar se me datë 27.11.2015, në Rrugën “...”, në Prishtinë, ishte shkaktuar fatkeqësia komunikacionit, me fajin e ngasësit të automjetit A me numër të targave 0....., i cili duke mos mbajtur distancën e duhur të sigurisë në mes të automjeteve, godet në pjesën e pasme automjetin nën B me numër të targave 0.....dhe si pasojë e kësaj goditje, lëndime trupore pësojnë paditësit Afrim, Agim dhe L.G. Paditësit ishin Shofer (A.G) përkatësisht pasagjer në automjetin B (Agim dhe L.G). Automjeti i udhëtarëve, me të cilin u shkaktua fatkeqësia ishte i siguruar te e paditura. Si pasojë e këtij aksidenti, paditësit kanë pësuar lëndime trupore, për çka kanë kërkuar edhe ndihmë mjekësore. Më tej thekson se si pasojë e këtyre lëndimeve, paditësit kanë pësuar dhimbje fizike të të gjitha intensiteve, kanë pësuar edhe frikë primare të të gjitha intensiteve dhe pasi që baza juridike nuk është kontestuese, konsiderojmë se shumat e kërkuara për të gjitha llojet e kompensimit janë reale, tërësisht të bazuara në provat e administruara, në pajtim me dëmin e pësuar dhe me praktikën gjyqësore, andaj mbi bazën e kësaj i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumë të përgjithshme prej 1,898.20€ dhe atë për padi shumë prej 416.00€, për përfaqësim në tri seanca gjyqësore shumë prej 811.20€, për precizimin e kërkesëpadisë shumë prej 416.00€, për taksë gjyqësore shumë prej 15.00€ dhe për ekspertizë mjekësore shumë prej 240.00€.

E paditura në përgjigje në padi, në seancat gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar, nuk e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë, por e kontestuar kërkesëpadinë vetëm për nga lartësia, për dëmin material dhe jo material, me pretendimin se shumat e kërkuara janë të pabazuara dhe të pa justifikuara, dhe po ashtu në kundërshtim me praktikën gjyqësore. Ka shtuar se me që është vërtetuar se në këtë rast janë shkaktuar lëndime të lehta trupore, kërkesëpadia duhet të refuzohet përtej shumave të ofruara nga kompania 1,000.00€ për secilin paditës. Ka propozuar që shpenzimet e procedurës të njihen vetëm shpenzimet suksesit në procedurë.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat: raporti i aksidentit datës 27.11.2015 me numër 3034; raportet nga Qendra Klinike Universitare -

Qendra Emergjente të datës 27.11.2015, për paditësit A.G me numër 44375, G... me numër 44397 dhe L.G me numër 44373; ekspertiza mjekësore nga lëmi i ortopedisë - traumatologjisë dhe psikiatrisë e datës 24.11.2020, fatura me numër 3187/2015 e datës 08.12.2015, dëftesat me numër 032824 dhe 023762 të datës 03.12.2015 për paditësin A.G dhe fatura me numër 3188/15 e datës 03.12.2015 për paditësin L. G si dhe dokumentacionin mjekësor mbështetës, mbi bazën e të cilit është hartuar ekspertiza mjekësore e datës 24.11.2020.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të LPK-së, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nga arsyet në vijim:

Mes palëve nuk ishte kontestues fakti se me datën 27.11.2015, kishte ndodhur aksident komunikacioni mes automjetit me numër të targave 0..... dhe automjetit 01-500-AC, e si pasojë e këtij aksidenti lëndime kishin pësuar këtu paditësit A, A dhe L.G, të cilët në kohën e aksidentin gjendeshin në automjetin 01-500-AC, fakt që provohet edhe me raportin e aksidentit numër 3034, të datës 27.11.2015, të përpiluar nga Policia e Kosovës.

Po ashtu mes palëve nuk ishte kontestues as fakti se shkaktar i aksidentit të komunikacionit, nga ka rrjedhur edhe dëmi, ka qenë i siguruar tek e paditura, me policën e sigurimit numër 0005394611, e vlefshme deri më 01.04.2016.

Çështje kryesore kontestuese mes palëve ndërgjyqëse mbetet lartësia e kompensimit, për të cilën përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse kanë paraqitur argumente të ndryshme mes tyre.

Nga Raporti i Policisë i datës 27.11.2015, numër 3034, konstatohet se deri tek aksidenti ka ardhur kur vozitësi i automjetit VW, me numër të targave 0..... duke mos iu përmbajtur rregullave të trafikut, duke mos mbajtur distancë të mjaftueshme, godet automjetin me e markës Mercedes, me numër të targave 01-500-AC, i cili kishte ndaluar për t'i dhënë përparësi këmbësorëve në vendkalim për këmbësor. Si pasojë e goditjes, lëndime pësojnë paditësit.

Gjykata gjeti se paditësit me datë 27.11.2015, pra ditën e ndodhjes së aksidentit, janë paraqitur në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës - Qendra Emergjente, për të kërkuar ndihmë mjekësore, për çka nga kjo e fundit janë përpiluar raportet mjekësore me numra 44373, 44375 dhe 44397, në të cilat evidentohen lëndimet e pësura nga paditësit dhe pranojnë trajtim mjekësor.

Për të përcaktuar natyrën dhe shkallën e lëndimeve në këtë aksident trafiku, gjykata me propozimin e palës paditëse ka nxjerrë provën përmes ekspertizës, me ekspertë nga lëmia e ortopedisë - traumatologjisë dhe psikiatrisë.

Eksperti ortoped – traumatolog Arbër Tolaj, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësve, ka konstatuar se paditësi A.G, si pasojë e aksidentit të shkaktuar ka pësuar lëndime trupore, që cilësohen si lëndime të lehta trupore. Andaj, Gjykata në emër të dhimbjeve fizike, aprovoi kërkesat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, meqë i vlerësoi si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse paditësi, si pasojë e lëndimeve të marra ka pësuar dhimbje fizike të intensiteteve të ndryshme, si shkak i lëndimeve trupore: distorzion i qafës dhe ndryshje e kafazit të kraharorit. Dhimbje me intensitet posaçërisht të rëndë nuk ka pasur, por të njëjtit ka pasur dhimbje me intensitet të rëndë 24 orë, kohë pas kohe deri në veprimin e terapisë, me theks të veçantë në regjionin e qafës dhe të gjoksit. Paditësit ka pasur dhimbje me intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 10 ditësh, kurse me intensitet të ulët 3 muaj. Lidhur me nevojën për ndihmën e personit të tretë, eksperti ortoped ka paraqitur se ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 3 ditë, për kryerjen e aktiviteteve të përditshme jetësore si ushqimi, veshmbathja, higjiena personale dhe ndihma gjatë trajtimit mjekësor për shkak të mbajtjes së detyruar të imobilizimit me qafore. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 10 ditë, i pajisur me minerale dhe vitamina, ushqim më i përforcuar se ai i zakonshëm. Eksperti ka konstatuar se për paditësin ka qenë i nevojshëm edhe rehabilitimi fizioterapeutik klimatik, në kohëzgjatje prej 10 ditësh, në vitin e parë të aksidentit. Po ashtu, eksperti ka gjetur se paditësi nuk ka zvogëlim të aktiviteti të përgjithshme jetësor, e as shëmtim trupor.

Lidhur me paditësin A.G, eksperti ortoped - traumatolog, ka konstatuar se i njëjti ka pësuar lëndime të lehta trupore. Gjykata në emër të dhimbjeve fizike aprovoi kërkesën në shumën prej 1,200.00€, duke vlerësuar si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse paditësi, si pasojë e lëndimeve të marra ka pësuar dhimbje fizike të intensiteteve të ndryshme, si shkak i lëndimeve trupore: ndrydhje e regjionit të qafës, krahut të majtë dhe regjionit lumbal. Dhimbje me intensitet posaçërisht të rëndë nuk ka pasur, por i njëjti ka pasur dhimbje me intensitet të rëndë 24 orë, kohë pas kohe deri në veprimin e terapisë, me theks të veçantë në regjionin e qafës, krahut dhe regjionit lumbal. Paditësi ka pasur dhimbje me intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 10 ditësh, kurse me intensitet të ulët 3 muaj. Lidhur me nevojën për ndihmën e personit të tretë, eksperti ortoped ka paraqitur se ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 3 ditë, për kryerjen e aktiviteteve të përditshme jetësore si ushqimi, veshmbathja, higjiena personale dhe ndihma gjatë trajtimit mjekësor. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 10 ditë, i pajisur me minerale dhe vitamina, ushqim më i përforcuar se ai i zakonshëm. Eksperti ka konstatuar se për paditësin ka qenë i nevojshëm edhe rehabilitimi fizioterapeutik klimatik, në kohëzgjatje prej 10 ditësh, në vitin e parë të aksidentit.

Po ashtu, eksperti ka gjetur se paditësi nuk ka zvogëlim të aktiviteti të përgjithshme jetësor, e as shëmtim trupor.

Lidhur me paditësin L.G, eksperti ortoped - traumatolog, ka konstatuar se e njëjta ka pësuar lëndime të lehta trupore. Gjykata në emër të dhimbjeve fizike aprovoi kërkesën në shumën prej 1,300.00€, duke vlerësuar si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse paditësi, si pasojë e lëndimeve të marra ka pësuar dhimbje fizike të intensiteteve të ndryshme, si shkak i lëndimeve trupore: ndrydhje e regjionit të qafës dhe krahorrit. Dhimbje me intensitet posaçërisht të rëndë nuk ka pasur, por të njëjtit ka pasur dhimbje me intensitet të rëndë 24 orë, kohë pas kohe deri në veprimin e terapisë, me theks të veçantë në regjionin e qafës dhe gjoksit. Paditësi ka pasur dhimbje me intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 10 ditësh, kurse me intensitet të ulët 3 muaj. Lidhur me nevojën për ndihmën e personit të tretë, eksperti ortoped – traumatolog ka konstatuar se ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 3 ditë, për kryerjen e aktiviteteve të përditshme jetësore si ushqimi, veshmbathja, higjiena personale dhe ndiha gjatë trajtimit mjekësor. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 10 ditë, i pajisur me minerale dhe vitamina, ushqim më i përforcuar se ai i zakonshëm. Eksperti ka konstatuar se për paditësin ka qenë i nevojshëm edhe rehabilitimi fizioterapeutik klimatik, në kohëzgjatje prej 10 ditësh, në vitin e parë të aksidentit. Po ashtu, eksperti ka gjetur se paditësi nuk ka zvogëlim të aktiviteti të përgjithshme jetësor, e as shëmtim trupor.

Në emër të kompensimit lidhur me frikë për paditësin A.G, gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 1,000.00€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse paditësi sipas mendimit të ekspertes së psikiatrisë Nazmie Musliu, në mendimin e saj lidhur me frikën, ka pasqyruar se paditësi si pasojë e aksidentit të shkaktuar, ka përjetuar Frikë primare prej disa sekondave, e manifestuar me frikë nga vdekja dhe kërcënimit direkt të integritetit fizik. Frikë sekondare të intensitetit të lartë 24 orë, kurse frikë sekondare të intensitetit të mesëm dhe të ulët, dy muaj.

Gjykata, për paditësin A.G, në emër të kompensimit për frikë, ka caktuar shpërblimin në shumë prej 1,000.00€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit. Kjo bazuar në ekspertizën e psikiatrisë, ku ekspertja në mendimin e saj lidhur me frikën ka pasqyruar se si pasojë e aksidentit të shkaktuar, paditësi ka përjetuar Frikë primare prej disa sekondave, e manifestuar me frikë nga vdekja dhe kërcënimit direkt të integritetit fizik. Frikë sekondare të intensitetit të lartë 24 orë, kurse frikë sekondare të intensitetit të mesëm dhe të ulët, dy muaj.

Gjykata, për paditësin L.G, i cili në kohën e aksidentit ka qenë i mitur, në emër të kompensimit për frikë, ka caktuar shpërblimin në shumë prej 1,100.00€, si shpërblim i drejtë dhe që i

shërben qëllimit të shpërblimit. Kjo bazuar në ekspertizën e psikiatrisë, ku ekspertja në mendimin e saj lidhur me frikën ka pasqyruar se si pasojë e aksidentit të shkaktuar, paditësi ka përjetuar Frikë primare prej disa sekondave, e manifestuar me frikë nga vdekja dhe kërcënimit direkt të integritetit fizik. Frikë sekondare të intensitetit të lartë 24 orë, kurse frikë sekondare të intensitetit të mesëm dhe të ulët, dy muaj.

Gjykata të dy ekspertizat mjekësore atë të ortopedisë - traumatologjisë dhe psikiatrisë, i ka pranuar në tërësi si të besueshme, me që të njëjtat ishin profesionale dhe të argumentuara, po ashtu e punuar sipas vëllimit të përcaktuar, po ashtu duke ofruar të dhëna lidhur vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Ligji Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, rregullon çështjen e kompensimit të dëmit (material dhe jo material), ashtu që me nenin 159 të tij ka përcaktuar se “Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjeti motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë”. Me nenin 137 të po këtij ligji përcaktohet se: Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material). Kurse me dispozitën e nenit 183, paragrafi 1, të po të njëjtit ligj, përcaktohet se Për dhembjet e pësura fizike, për dhembjet e pësura shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material. Prandaj gjykata duke u bazuar në këto dispozita si dhe duke i vlerësuar të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit jomaterial, posaçërisht duke marr parasysh natyrën dhe shkallen e dëmtimeve trupore të shkaktuar për paditësit, vlerësimin në ekspertizave mjekësore, gjykata miratoj pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve të bazuar e në vlerën e shpërblimit të dëmit si në piken II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se shumatat e kompensimit të aprovuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi janë adekuate, duke marr parasysh dëmin që i është shkaktuar paditësve dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit, do t'i mundësoj paditësve satisfaksion që ata të jetë në gjendje që deri në një masë, t'i kompensoj të mirat jo materiale nga të cilat janë privuar, respektivisht atë shkallë të satisfaksionit të cilën ai do ta kishte po qesë të njëjtit nuk do t'i kishin humbur, e krejt kjo duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e lëndimeve të shkaktuara, intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës, kohëzgjatjen e tyre dhe kohën e nevojshme të shërimit.

Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit material dhe jomaterial, si dhe në lidhje me shumën kompensimit të këtij dëmi, mes tjerash gjykata ka pasur parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cili i shërben ky kompensim, e gjithashtu kriteret e vëna nga praktika gjyqësore.

Në emër të ushqimit të përforcuar për paditësit A.G, A.G dhe L.G, gjykata ka caktuar kompensimin në shumën nga 100.00€, për secilin, sepse sipas mendimit të ekspertit ortoped – traumatolog, si pasojë e aksidentit, paditësit, secili veç e veç, kanë pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 10 ditë, ushqim i pasur me minerale dhe vitamina, ushqim më i përforcuar se ai i zakonshëm.

Në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj për paditësit A.G, A.G dhe L.G, gjykata ka caktuar kompensimin në shumën nga 30.00€, për secilin paditës veç e veç, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse secili nga paditësit, sipas mendimit të ekspertëve të mjekësisë, si pasojë e aksidentit kanë pasur nevojë për ndihmën dhe kujdesin e huaj për t'i kryer shumicën e aktiviteteve të përditshme jetësore në kohëzgjatje prej 3 ditë.

Gjykata për kategoritë e dëmit ushqim i përforcuar dhe ndihmë dhe kujdes i huaj, vlerëson se mund të caktohet edhe në mungesë të provave materiale, ngase është standard i ndërtuar tashmë nga praktika gjyqësore, dhe vështirë i argumentuar. Andaj me çmuarje të lirë dhe konform nenit 323 të Ligjit Nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore ka ardhur në përfundim se shumata e gjykuara të shpërblimit të dëmit për këto kërkesa janë në përputhje me dëmin e pësuar sipas këtyre bazave.

Lidhur me pjesën e kërkesëpadsisë që ka të bëjë me shpenzime materiale gjatë kohës së shërimit, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase përmes faturave që janë administruar si provë, është arritur të argumentohet se shpenzimet e tilla, i përshtaten trajtimit që kanë pranuar lidhur me aksidentin e pësuar. Andaj gjykata, ka aprovuar shpenzimet e shërimit për paditësin A.G në shumë të përgjithshme prej 28.00€ dhe atë për ekzaminim neurokirurgjik, në bazë të faturës numër 3187/15, e datës 08.12.2015, të lëshuar nga Royal Medical dhe dëftesave me numra 032824 dhe 023762, të datës 03.12.2015, të lëshuara nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës. Kurse për paditësin L.G në shumë prej 20.00€, për ekzaminim neurokirurgjik, sipas faturës 3188/15, të datës 03.12.2015, të lëshuar nga Royal Medical.

Gjykata, ka vendosur si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për refuzimin e kërkesëpadsisë që ndërlihet me dëmin jomaterial, pasi që vlerësoj se kompensim përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që

kompensimi të ishte i drejtë. Kurse sa i përket dëmit material, gjykata ka refuzuar kërkesëpadinë përtej shumave të gjykuara për këto arsye: Për paditësin A.G ka refuzuar shpenzimet e shërimit në lartësi prej 20.00€, nga se nga provat e administruara rezulton se nga paditësi janë provuar shpenzimet deri në lartësi prej 28.00€, kurse shuma e kërkuar në padi është 48.00€. Ndërsa sa i përket rehabilitimit fizioterapeutik klimatik, gjykata ka refuzuar pjesën e kërkesëpadiisë për këtë kategori të kompensimit për të tre paditësit, sepse nuk janë ofruar prova mbi bazën e të cilave do të provoheshin shpenzimet e bëra për qëllime të këtij kompensimi të pretenduar. Po ashtu, gjykata, të tre paditësve u ka refuzuar kërkesëpadinë në shumë prej 100.00€, për ushqim të përforcuar, kurse për përkujdesje të personit të huaj shumë nga 170.00€. Kjo pasi që në vlerësimin e gjykatës, vlera e njohur për këto shpenzime janë të bazuara në praktikën gjyqësore për këtë lloj të kompensimit, përputhen në kohëzgjatjen e nevojës për ushqim të përforcuar, që sipas mendimit të ekspertit ka qenë 10 ditë për secilin paditës, dhe për kujdes të personit të tretë, që sipas mendimit të ekspertit ka qenë e nevojshme për 3 ditë për secilin paditës,

Duke qenë se pas administrimit të të gjitha provave, gjykata ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë, po ashtu ka vërtetuar se të paditësve u takon edhe kamatëvonesa, e përcaktuar me nenin 382 të Ligjit Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, sipas të cilit Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhi të kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8 %) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë. Kamata për dëmin material, në lartësi prej 8% në vit, fillon të rrjedh nga data e ushtrimit të padisë në gjykatë, përkatësisht nga data 08.01.2016, kurse për dëmin jo material nga data e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, përkatësisht data 11.02.2021, e gjerë në përmbushjen e plotë të detyrimit.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e neneve 449 dhe 452 të LPK-së, sipas të cilave paditësve u pranohen shpenzimet në shumën e përgjithshme prej 1,139.00€ dhe atë në emër të përpilimit të padisë, shumën prej 208.00€, për pjesëmarrje në seanca gjyqësore të mbajtura shumën 540.80€ (2x270.4 euro), për një seancë të shtyrë pa fajin e paditësit shumën prej 135.20€ (vlera 50% e një seance të mbajtur me tarifë 270.4 euro), për taksë për padi shumën prej 15.00€ dhe për ekspertizë mjekësore shumën prej 240.00€. Gjukata nuk ka njohur shpenzimet mbi shumën prej 1,139.00€ e deri në shumën prej 1,898.20€ dhe atë për përpilim të padisë shumën prej 208.00€ nga se në këtë çështje kontestimore kemi të bëjmë me kontest mbi vlerën e vogël deri në 10,000.00€ (edhe vet paditësi në shpenzimet e kërkuara për seanca gjyqësore i është referuar kësaj vlere të kontestit) dhe paditësi i përfaqëson tre paditës, ashtu që për padi i takon kompensimi në lartësi

prej 208.00€ dhe jo 416.00€ siç është kërkuar t'i kompensohet. Po ashtu gjykata nuk ka njohur edhe shpenzimet e kërkuara në shumë prej 416.00€ për parashtresën e datës 21.12.2020, të dorëzuar në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 01.02.2021, për precizim të kërkesëpadisë, pasi që ky kompensim është konsumuar me shpenzimet e njohura për padi dhe se parashtresa në fjalë ka të bëjë me rregullimin e padisë në kuptimin objektiv si dhe shumën prej 135.20€ në vlerë të 50% të një seance të shtyrë pa fajin e paditësit, të gjitha këto bazuar në Rregulloren për Tarifat e Odës së Avokatëve të Kosovës të datës 18.03.2017, përkatësisht tariforit 6 dhe 7, e për seancën e shtyrë paragrafi 1, i tariforit 7, 1 ku është përcaktuar se për përfaqësim në seanca për çështje civile dhe të tjera avokatit i takon për çdo seancë të shtyrë pa fajin e avokatit, shuma prej 50 % të shpërblimit nga paragrafi paraprak e këtij numri tarifor.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.61/16, datë 11.02.2021

Gjyqtari

Nexhat Qallapeku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të tij, Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.